

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E MAMUSHËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-24-10882-5-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj **SEFERI-CO SHPK**
NUI **810100537**
Adresa **Magjistrala Prizren Suhareke**
Vendi **Suhareke**
Kodi postar **23000**
Numri Telefonit **+38344715553**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj **Bujar Seferaj**
Adresa elektronike **sefericompany@gmail.com**
Data e parashtrimit të kërkesës **22.10.2024**

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

AK ka publikuar NJK dhe DT me date: 17.10.2024

Ne kemi analizuar kërkesat e FDT-se dhe kemi verejtur se AK ka vendosur kërkesa ne kundërshtim me nenin 1, 7 dhe 69 të LPP-se.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK komuna Mamushë, në NJ dhe DT të publikuar me datë: 17.10.2024, ka kërkuar stafë specific dhe me disa kualifikime për të njëjtin person/inxhinier.

Në kërkesat e Kapacitetit teknik dhe professional në pikën nr.2. nënpika 2.1 AK ka kërkuar:

2. OE, duhet të ketë staf te mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur në projekt,
punëtor te rregullt ose me parakontratë nga të cilët minimumi

2.1 O.E. duhet të caktoj me vendim menaxherin e kontratës për këtë projekt i cili duhet te jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi konstruktiv) të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune. i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri si dhe të jetë specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierëve të ndërtimit.

Pra bazuar në kërkesën e FDT-së në pikën 2.1 I njëjti inxhinier duhet që të jetë:

-inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi konstruktiv)

-të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune.

-i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë

-i certifikuar për mbrojtje nga zjarri

-si dhe të jetë specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierëve të ndërtimit.

Me këtë kërkesë AK ka bërë kufizim të konkurrencës dhe ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-dhe nenit 1 të LPP-së. Pra AK nuk i ka trajtuar OE njëte dhe ka bërë diskriminime në këto kërkesa sepse OE mundë të kenë disa inxhinier që plotësojnë kërkesat e FDT-së, por janë raste të veqanta dhe shumë specifike ku I njëjti person I ka të gjitha këto certifikime. Nëse AK do të vepronte conform LPP-së do të kërkonte që këto certifikime ti ketë stafi I OE e jo I njëjti person. Andaj kërkesat e tilla janë në kundërshtim me LPP-në dhe kërkojme që të eliminohen plotësishtë.

Njëte AK ka vepruar edhe në pikat 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6 dhe 2.7 të kërkesës për staf në kërkesat e FDT-së për kapacitetin teknik dhe professional:

2.2 Një inxhinier të diplomuar ose bachelor të Arkitekturës, kërkohet të ketë min. 3(tre) vite ërvojë pune pas diplomimit në angazhime profesionale. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri.

2.3 Një (1) inxhinier të diplomuar ose master drejtimi Hidroteknik .

2.4 Një inxhinier të diplomuar ose bachelor drejtimi Gjeodezi, i licencuar me licencë

valide kërkohet të ketë min. Pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit në angazhime profesionale.

2.5 Një udhëheqës i punishtes teknik I ndërtimtarisë. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri.

2.6 Një ekspert të certifikuar për sistemet e drenazhimit. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri.

2.7. Operatori Ekonomik duhet të ketë së paku dhjetë (10) punëtorë të rregullt ose me parakontratë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe për mbrojtje nga zjarri.

Meqense ky aktivitet I prokurimit është vlerës e mesme, dhe bazuar në përshkrimin e puneve të kërkuara, kërkojmë nga AK që të hjek apo eliminojë kërkesat e FDT-së sa I përket certifikimeve të punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë sepse një kërkesë e tillë për këtë kapacitet është në kundërshtim me Ligjin 04/L-161 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, për më tepër është kërkesë kufizuese dhe eliminon konkurrencën me qka shkakton shkelje të nenit 7 të LPP-së.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

Po ashtu kërkojmë që kërkesa e FDT-së për pikën 2.5 dhe 2.6 të eliminohen plotësisht sepse bazuar në natyrën e projektit dhe përshkrimin të pozicioneve janë kërkesa të panevojshme dhe nuk lidhen me këtë aktivitet të prokurimit dhe janë në kundërshtim me nenin 69 të LPP-së.

Po ashtu në kërkesat e kapacitetit teknik dhe professional, AK në FDT ka kërkuar disa prej pajisjeve që janë kufizuese për nga pasha dhe po ashtu janë pajisje të cilat nuk janë të

nevojshme për realizim të këtij projekti:

Ngjeshese hidraulike, montuese ne eskavator

Makinë ngjeshëse max. 70 kg

Dumper 2.5 tonë

Sperkatese per bitumen dhe emulsion max. 2 tonë

Greder nivelizues dixhital max. 10 tonë

Frezë hidraulike për gërryerje të gurit minimum 1500 kg

Frezë montuese në eskavator për gërryerjen e asfaltit, gurit dhe betonit max. 500 kg

Frezë montuese në eskavator për gërryerjen e asfaltit, gurit dhe betonit max. 500 kg

Makineri për vendosje të kubëzave të betonit min. 1.5 tonë

Pajisje vakum ngritëse për vendosje të anësoreve minimum 500 kg

Kompresor ajri të montuar mbi një shasi me rrota

Pra janë kërkuar pasha specifike siq është 70kg, pastaj ngjeshësi hidraulik është I

panevojshëm në rastin kur kemi disa lloje të cilindrave që janë kërkuar.

Kërkojmë nga AK që pajisjet që i kemi cekur më sipër, të hiqen dhe të mbesin pajisjet tjera të cilat janë të nevojshme për realizim të projektit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne jemi demtuar ne apsektin konkurues sepse AK ka kufizuar konkurencen ne start te kesaj procedure.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.